



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr.22, datë 05.12.2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR KRYERJE SHPIMI
NËNTOKËSOR PËR NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI), TË SUBJEKTIT
“ERGYS SELA”, ME VENDNDODHJE: ISHULL-LEZHË, LEZHË**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi), të subjektit “ERGYS SELA”, me vendndodhje: Ishull-Lezhë, Lezhë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)

X=466653; Y=4624301; Z=1 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për përdorim familjar

Prurja e ujit të kërkuar: $Q=0.3$ l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 14 m

Diametri pus-shpimit = $\varnothing 650$ mm, thellësia nga 0 deri në 14 m.

3. Ngarkohet Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

